



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2817/ 12 prot.

Datë 07.04.2023

V E N D I M
Nr. 262/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.04.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH & “*Abkons*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr. REF- 45735-10-13-2022, me objekt: “*Studim i Fizibilitetit dhe Projekt - Ide për Lidhjen Hekurudhore Durrës - Prishtinë*”, me fond limit 200,224,996 (dyqind milionë e dyqind e njezetë e katër mijë e nëntë qind e nëntë dhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH ose 1.708.696 Euro (një milion e shtatëqind e tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) Euro kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 07.10.2022, 1 euro = 117.18 lekë, zhvilluar me datë 07.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Hekurudha Shqiptare.

Ankimues:

Bashkimi operatorëve ekonomik “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH & “*Abkons*” SHPK
Adresa: Rruga “Themistokli Gërmenji”, Përball RTSH,
Kati II, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Hekurudha Shqiptare.
Adresa: Rruga “Egnatia”, Lagjia nr. 3, Durrës.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Bashkimi operatorëve ekonomikë ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 14.10.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Shërbim Konsulence”, me Nr. REF- 45735-10-13-2022, me objekt: “Studim i Fizibilitetit dhe Projekt - Ide për Lidhjen Hekurudhore Durrës -Prishtinë”, me fond limit 200,224,996 (dyqind milionë e dyqind e njetetë e katër mijë e nëntë qind e nëntë dhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH ose 1.708.696 Euro (një milion e shtatëqind e tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) Euro kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 07.10.2022, 1 euro = 117.18 lekë, zhvilluar me datë 07.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Hekurudha Shqiptare.

II.2. Në datë 07.12.2022 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (*shprehja e interesit*) nga verifikimi i së cilës rezulton se kanë shprehur interes operatorët ekonomikë si më poshtë cituar:

1. “Dromos Consulting” LTD
2. BOE “ILF Consulting Engineers Austria” GmbH & “Abkons” SHPK
3. “Tecnica y Proyectos” S.A
4. “Yuksel Proje” A.S
5. “Hill International” NV
6. “Tecnic Consulting Engineers” SpA
7. “Studio Archimed” SHPK

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se në datën 08.12.2022, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës duke i njoftuar operatorët ekonomikë me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), nga ku rezulton se në këtë fazë janë kualifikuar/skualifikuar operatorët ekonomikë si më poshtë:

- | | |
|--|--------------|
| 1. “Tecnica y Proyectos” S.A | kualifikuar |
| 2. “Yuksel Proje” A.S | kualifikuar |
| 3. “Dromos Consulting” LTD | skualifikuar |
| 4. “Hill International” NV | skualifikuar |
| 5. BOE “ILF Consulting Engineers Austria” GmbH & “Abkons” SHPK | skualifikuar |
| 6. “Studio Archimed” SHPK | skualifikuar |
| 7. “Tecnic Consulting Engineers” SpA | skualifikuar |

II.4. Më datë 08.12.2022 autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike ka njoftuar bashkimin e operatorit ekonomikë “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH & “*Abkons*” SHPK për vlerësimin e fazës së parë të procedurës së prokurimit nga ku rezulton, se ky operator ekonomik është skualifikuar me arsyet si më poshtë vijojnë:

1- The Economic Operator ILF Consulting Engineers Austria GmbH has presented financial sheets of 2019 and 2020 but it has not presented financial sheets of 2021 according to the standard bidding documents. As per above, this criterion is considered unfulfilled. Operatori Ekonomik ILF Consulting Engineers Austria GmbH ka paraqitur pasqyrat financiare të vitit 2019 dhe të vitit 2020 por nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të vitit 2021 sipas kërsave dokumentave standarteve të tenderit. Sa me sipër ky kriter konsiderohet i paplotesuar.

2- The Bidder ILF Consulting Engineers Austria GmbH has presented an invalid ISO Certificate 9001:2015 on “Quality Management System” No. 01555/12, issued by Qualityaustria, hereby the validity period has expired on 05.11.2022. As per above, this criterion is considered unfulfilled. Operatori Ekonomik ILF Consulting Engineers Austria GmbH, ka paraqitur ISO

9001:2015 për “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” me numër regjstrimi 01555/12 nga *qualityaustria* të pavlefshme e cila ka përfunduar afatin e vlefshmërisë me datë 05.11.2022. Sa me sipër ky kriter konsiderohet i paplotësuar.

II.6. Në datën 19.12.2022, bashkimi i operatorëve ekonomikë “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH & “*Abkons*” SHPK, ka paraqitur njëkohësisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij nga kjo procedurë prokurimi.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2817/2 prot., datë 20.12.2022 janë publikuar arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorit ekonomik “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH & “*Abkons*” SHPK

II.8. Me shkresën me nr. 979/10 prot., datë 23.12.2022, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2817/3 prot., datë 27.12.2022, autoriteti kontraktor ka paraqitur informacion dhe dokumentacion për procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH & “*Abkons*” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit nuk e ka trajtuar ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH & “*Abkons*” SHPK.

II.9. Me shkresën nr. 2817/4 prot., datë 11.01.2023, Komisioni i Prokurimit Publik ka vënë në dijeni autoriteti kontraktor dhe bashkimin e operatorëve ekonomik se se për një shqyrtim sa më të drejtë, transparent dhe objektiv të ankesës ka kërkuar informacion shtesë, dhe verifikim nga palë të treta (institucione shtetërore vëndase/huaja, kombëtare/ndërkombëtare), dhe në referim të nenit 115 pika 5 e ligjit nr. 162/2020, “*Për prokurimin publik*”, afatet për shqyrtimin e ankesës nr. 2817 prot, datë 19.12.2022 do të ndërpriten deri në mbërritjen e informacionit të kërkuar.

II.10. Me shkresën nr. 2817/5 prot., datë 12.01.2023, me objekt “*Kërkesë për Informacion*”, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar Ambasadës së Republikës Federale të Austrisë në Shqipëri, nga e cila kërkon informacion si më poshtë vijon:

Komisioni i Prokurimit Publik i Republikës së Shqipërisë është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit publik, koncesioneve/partneritetit publik privat, ankandeve dhe lejeve minerare për operatorët ekonomikë vendas dhe të huaj.

Komisioni i Prokurimit Publik është person juridik publik, i pavarur, që financohet nga buxheti i shtetit dhe i raporton Kuvendit. Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e

paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës. Kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik rregullohen nga neni 24 e vijues të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Pranë Komisionit të Prokurimit Publik është paraqitur një ankesë e një bashkimi operatorësh ekonomikë, ku një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë është një shoqëri e regjistruar në regjistrat tregtarë Austriak.

Një ndër objektet e shqyrtimit administrativ të ankesës së paraqitur lidhet gjithashtu edhe me aplikimin e ligjit në vendin e origjinës, Republikës Fedearale të Austrisë për dorëzimin e pasqyrave financiare të shoqërive tregtare.

Ndaj, në mbështetje të nenit 115 pika 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 103 pika 2 të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe neni 31 pika 1 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, na shfaqet i nevojshëm informacioni për sa më poshtë vijon :

- I- Sipas legjislacionit të Republikës Federale të Austrisë, cili është afati përfundimtar (datë/muaj/vit) që një subjekt i regjistruar në regjistrat tregtarë Austriak ka detyrim ligjor të deklarojë/auditojë/certifikojë pasqyrat e tij financiare pranë organeve shtetërore ose subjekteve të tjera për vitin ushtrimor 2021.*

Për vetë rëndësinë, që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, si dhe për një shqyrtim transparent të plotë dhe objektiv të ankesës, do të vlerësonim dërgimin e një informacioni të detajuar në një kohë sa më të shpejtë.

II.11. Me shkresën nr. 2817/6 prot., datë 12.01.2023, me objekt “Kërkesë për Informacion”, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar Ministrisë së Financava të Republikës Federale të Austrisë, nëpërmjetë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë nga e cila kërkon informacion si më poshtë vijon:

Komisioni i Prokurimit Publik i Republikës së Shqipërisë është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit publik, koncesioneve/partneritetit publik privat, ankandeve dhe lejeve minerare për operatorët ekonomikë vendas dhe të huaj.

Komisioni i Prokurimit Publik është person juridik publik, i pavarur, që financohet nga buxheti i shtetit dhe i raporton Kuvendit. Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës. Kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik rregullohen nga neni 24 e vijues të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Pranë Komisionit të Prokurimit Publik është paraqitur një ankesë e një bashkimi operatorësh ekonomikë, ku një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë është një shoqëri e regjistruar në regjistrat tregtarë Austriak.

Një ndër objektet e shqyrtimit administrativ të ankesës së paraqitur lidhet gjithashtu edhe me aplikimin e ligjit në vendin e origjinës, Republikës Fedearale të Austrisë për dorëzimin e pasqyrave financiare të shoqërive tregtare.

Ndaj, në mbështetje të nenit 115 pika 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 103 pika 2 të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit 31 pika 1 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, na shfaqet i nevojshëm informacioni nga ana juaj për sa më poshtë vijon :

I- Sipas legjislacionit të Republikës Federale të Austrisë, cili është afati përfundimtar (datë/muaj/vit) që një subjekt i regjistruar në regjistrat tregtarë Austriak ka detyrim ligjor të deklarojë/auditojë/certifikojë pasqyrat e tij financiare pranë organeve shtetërore ose subjekteve të tjera për vitin ushtrimor 2021.

Për vetë rëndësinë, që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, si dhe për një shqyrtim transparent të plotë dhe objektiv të ankesës, do të vlerësonim dërgimin e një informacioni të detajuar në një kohë sa më të shpejtë.

II.12. Me shkresën me nr. 33/1 prot., datë 14.02.2023, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2817/7 prot., datë 15.02.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e prokurimit Publik për përshpejtimin e shqyrtimit të ankesës dhe daljen me një vendim sa më shpejtë të jetë e mundur.

II.13. Me shkresën nr. 2817/9 prot., datë 29.03.2023, me objekt “Kërkesë për Informacion”, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë nga e cila kërkon informacion si më poshtë vijon:

Komisioni i Prokurimit Publik i Republikës së Shqipërisë është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit publik, koncesioneve/partneritetit publik privat, ankandeve dhe lejeve minerare për operatorët ekonomikë vendas dhe të huaj.

Komisioni i Prokurimit Publik është person juridik publik, i pavarur, që financohet nga buxheti i shtetit dhe i raporton Kuvendit. Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës. Kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik rregullohen nga neni 24 e vijues të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Me shkresën nr. 2817/8 prot, datë 20.02.2023 Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar institucionit tuaj ku ju bën me dije se pranë Komisionit Prokurimit Publik është paraqitur një ankesë e një bashkimi operatorësh ekonomikë, ku një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë është një shoqëri e regjistruar në regjistrat tregtarë Austriak. Një ndër objektet e shqyrtimit administrativ të ankesës së paraqitur lidhet gjithashtu edhe me aplikimin e ligjit në vendin e origjinës, Republikës Fedearale të Austrisë për dorëzimin e pasqyrave financiare të shoqërive tregtare. Ndaj dhe për këtë arsye Komisionit Prokurimit Publik i nevojitet informacion zyrtar nga institucionet përgjegjëse (administrata tatimore) të vendit origjinës së operatorit ekonomik ankimues “ILF CONSULTING ENGINEERS AUSTRIA” GmbH konkretisht nga Ministria e Financave të Republikës Federale të Austrisë.

Sa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, për vetë rëndësinë, që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, kërkojm të na informoni nëse është kthyer përgjigje pranë institucionit tuaj për shkresën nr. 2817/6 prot, datë. 14.02.2023 nga Ministria e Financave të Republikës Federale të Austrisë, nëse do të kemi një përgjigje nga Ministria e Financave të Republikës Federale të Austrisë, do të vlerësonim dërgimin nga ana juaj sa më shpejtë të jetë e mundur pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.14. Me shkresën me nr. 33/2 prot., datë 03.04.2023, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2817/10 prot., datë 05.04.2023, autoriteti kontraktor ka rivënë në dijeni Komisionin e prokurimit Publik për përshpejtimin e shqyrtimit të ankesës dhe daljen me një vendim sa më shpejtë të jetë e mundur.

II.15. Me datë 06.04.2023 nëpërmjetë postës elektronike Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Republikës së Shqipërisë ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik në lidhje me informacionin e kërkuar, i cili është protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me shkresën nr. 2817/11 prot., datë 06.04.2023me përmbajtje si më poshtë vijon:

Referuar rregullores së përgjithshme standarde për raportimin ligjor financiar në Austri: kompanitë që operojnë në tregun austriak, e kanë detyrim ligjor të kryejnë raportimin vjetor financiar jo më vonë se 5 muaj nga data e dorëzimit të pasqyrës së bilancit financiar. Data e dorëzimit të bilancit financiar varion nga madhësia e kompanisë dhe statusi juridik. Në rastin konkret, për “sh.p.k”(GmbH – ekuivalent i LLC në vendet anglo – saksone), deklarata për tatim mbi fitimin në Austri (UVA-TVSH-VAT) bëhet 4 herë në vit për ndërmarrjet, të cilat kanë deklaruar fitim më pak se €100K për vitin e mëparshëm. Në rastet kur fitimet e deklaruarra janë në €35K, nuk ka nevojë për deklarim të mëvonshëm, në rast se pagesat përkatëse janë kryer në datat specifike, përkatësisht: 15 shkurt, 15 maj, 15 gusht, 15 nëntor. Si rregull, për kompanitë që dorëzojnë bilancin financiar në 31 dhjetor, kanë kohë të dorëzojnë raportimin vjetor financiar deri në 30 mars. Ato që bëjnë deklarimin në 30 qershor, duhet të dorëzojnë raportin vjetor financiar deri në fund të shtatorit. 9 muaj pas dorëzimit të bilancit financiar, zyra e operatorit të firmës është e detyruar në bëj publikimin e

hapur në regjistrin publik të auditit (në rastin e firmave të mëdha si Kleopatra, raporti përfshihet në publikimin zyrtar të gazetës “*Äiener Zeitung*”).

Referuar përjashtimit si pasojë e pandemisë dhe lehtësimet e marra nga qeveria austriake: për shkak të vështirësive të krijuara nga pandemia COVID-19, afati përfundimtar për dorëzimin e raportit vjetor financiar u vendos të shtyhej nga 5 deri në 9 muaj. Ndërsa afati për hedhjen në regjistrin publik, u shty nga 9 deri në 12 muaj (Vendim i marrë nga Këshilli Kombëtar – Parlamenti- i Austrisë në datën 19 maj 2022 dhe hyrë në fuqi në datën 11 qershor 2022). Ky vendim vlente për dorëzimin e raportit vjetor financiar për firmat me afat bilanci financiar deri më 31 dhjetor 2021, për të cilat afati i përgatitjes nuk skadonte më në 16 mars 2020. Në këtë kuadër, për firmat që kishin bilanc financiar të dorëzuar deri në 31 dhjetor 2021, raportimi vjetor financiar duhej të kryhej deri në 30 shtator 2022, ndërsa hedhja në regjistrin publik deri në 31 dhjetor 2022. Për bilancet financiar pas 31 dhjetorit 2021 dhe deri në 29 prill 2022, rregulli ndryshon përkatësisht për raportin vjetor financiar ishte 30 shtatori 2022, ndërsa për regjistrin publik afati ishte 31 dhjetori 2022. Dhe për bilancet financiare me afat nga 30 prilli 2022 e pas, ri hynte në fuqi rregullorja standarde me afatet përkatësisht 5 muaj për raportimin vjetor financiar pas dorëzimit të bilancit financiar, dhe 9 muaj (nga dorëzimi i bilancit financiar) për hedhjen në regjistrin publik.

Për periudhën 2019 – 2021, qeveria austriake ndoqi një politikë të ngjashme. Vendimi i qeverisë austriake për hedhjen e të dhënave në regjistrin publik u shty me 12 maj, por u aplikua në ato raste kur bilancet financiare nuk kishin afat dorëzimi datën 16 mars brenda periudhës 6 mujore, dhe për të cilat afati përfundimtar ishte përpara datës 1 gusht 2020. Kjo përkthehet për operatorët që, detyrimi i dorëzimit të raporti financiar vjetor vlen në ato raste afati i dorëzimit të bilancit financiar binte në periudhën midis datës 16 tetor 2019 dhe 31 korrik 2020. Për të gjitha raportimet vjetore financiare me një bilanc financiar pas 31 korrikut 2020, aplikohet sërish detyrimi i mëparshëm 9-mujor. Kështu, për bilancin financiar nga 31 gushti 2020, detyrimi ligjor për hedhjen e të dhënave në regjistrin publik ishte 9 muaj pas, pra maksimumi 31 maj 2021.

II.16. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur nga BOE “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH & “*Abkons*” SHPK, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH & “*Abkons*” SHPK, me argumentet se: “*ka paraqitur*

ISO 9001:2015 për “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” me numër regjstrimi 01555/12 nga qualityaustria të pavlefshme e cila ka përfunduar afatin e vlefshmërisë me datë 05.11.2022. Sa me siper ky kriter konsiderohet i paplotesuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 11/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

Ishte:

Operatori ekonomik duhet të ketë certifikatat e mëposhtme:

- a) *Operatori ekonomik paraqet Certifikatën ISO 14001: 2015 “Për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor” (e vlefshme) ose një ekuivalente në përputhje me objektin e kontratës. Në rastin e sipërmarrjes së përbashkët të operatorëve ekonomikë, të paktën vetëm një anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e sipërpërmendur.*
- b) *Operatori ekonomik do të paraqesë Certifikatën ISO EN 9001: 2015 për “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” (e vlefshme) ose një ekuivalente në përputhje me objektin e kontratës. Në rastin e sipërmarrjes së përbashkët të operatorëve ekonomikë, të paktën një anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e sipërpërmendur.*

Këto certifikata lëshohen nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organi kombëtar i akreditimit ose organizmat ndërkombëtarë të akreditimit, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Bëhet:

Operatori ekonomik duhet të ketë certifikatat e mëposhtme:

- a) *Operatori ekonomik paraqet Certifikatën ISO 14001:2015 “Për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor” (e vlefshme) ose një ekuivalente në përputhje me objektin e kontratës. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të shërbimeve që do të marrë përsiper të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit).*
- b) *Operatori ekonomik do të paraqesë Certifikatën ISO SSH EN 9001: 2015 për “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” (e vlefshme) ose një ekuivalente në përputhje me objektin e kontratës. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të shërbimeve që do të marrë përsiper të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit).*

Këto certifikata lëshohen nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organi kombëtar i akreditimit ose organizmat ndërkombëtarë të akreditimit, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorit ekonomikë “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH & “*Abkons*” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Kontratë Bashkëpunimi për “Studim i Fizibilitetit dhe Projekt Ide për Lidhjen Hekurudhore Durrës – Prishtinë”, me Nr. 6998 Rep, Nr. 4216 Kol, datë 11.11.2022. Midis operatorit ekonomik “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH dhe operatorit ekonomik “*Abkons*” SHPK
- “*Abkons*” SHPK Certifikatë ISO 9001:2015, për fushat e veprimtarisë Shërbimi i menaxhimit të të gjithë llojeve të projekteve, përfshirë projektet ndërkombëtare. Studime me bazë socio-ekonomike dhe mjedisore përfshirë EIA për projekte madhore. Këshillim ligjore dhe financiar. Përgatitja dhe përpunim i strategjive sektoriale dhe planeve të veprimit përfshirë studimet e fisibilitetit. Shërbime teknike përfshirë mbikqyrjen dhe projektimin e punimeve për të gjitha kategoritë e parashikuara në licencat përkatëse. E vlefshme deri në 23.11.2023.
- “*Abkons*” SHPK Certifikatë ISO 14001:2015, për fushat e veprimtarisë Shërbimi i menaxhimit të të gjithë llojeve të projekteve, përfshirë projektet ndërkombëtare. Studime me bazë socio-ekonomike dhe mjedisore përfshirë EIA për projekte madhore. Këshillim ligjore dhe financiar. Përgatitja dhe përpunim i strategjive sektoriale dhe planeve të veprimit përfshirë studimet e fisibilitetit. Shërbime teknike përfshirë mbikqyrjen dhe projektimin e punimeve për të gjitha kategoritë e parashikuara në licencat përkatëse. E vlefshme deri në 23.11.2023.
- “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH Certifikatë ISO 9001:2015, për fushat Konsulencë/studime, dizajn/inxhinieri, tenderim/prokurime, mbikqyrje ndërtimi, menaxhim ndërtimi, start up/vënien në punë, menaxhim projekti. E vlefshme deri në 05.11.2022.

III.1.3. Në nenin 2 “*Qëllimi*” të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se

është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 4 “Përkufizime” pika 17 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.6. Në nenin 41, pika 1, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor në përcaktimin e fituesve të kontratave publike zbaton procedurat e parashikuara në këtë ligj.

Llojet e procedurave të prokurimit publik janë:

- a) procedurë e hapur;
- b) procedurë e kufizuar;
- c) procedurë konkurruese me negociim, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave të sektorit klasik;
- ç) partneritet për inovacion;
- d) dialogu konkurrues;
- dh) procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave sektoriale;
- e) procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;
- ë) procedurë e hapur e thjeshtuar;
- f) **shërbim konsulence.**

III.1.7. Në nenin 50 “Shërbimi Konsulencës” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

1. Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me fazë, e cila shërben për prokurimin e kontratave publike për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese.
2. Në procedurat mbi kufirin e lartë monetar, çdo operator ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të njoftimit që përmban informacionin e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik.

Afati kohor minimal për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje është jo më pak se 30 ditë nga data në të cilën është publikuar njoftimi i kontratës ose ftesa për shprehje interesi.

3. Në fazën e dytë, ofertë mund të paraqesin vetëm kandidatët e përzgjedhur nga autoriteti kontraktor.

Afati minimal për pranimin e ofertave është jo më pak se 30 ditë, nga data në të cilën është publikuar ftesa për ofertë.

4. Në procedurat mbi kufirin e lartë monetar, autoriteti kontraktor mund të shkurtojë me 5 ditë afatin kohor për marrjen e kërkesave ose ofertave, të përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, në rast se procedura e prokurimit zhvillohet me mjete elektronike.

5. Për procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, afati për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje ose ofertave është jo më pak se 20 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose ftesës për ofertë dhe në rast se procedura e prokurimit zhvillohet me mjete elektronike, ky afat mund të shkurtohet me 5 ditë.

6. Për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, afati për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje ose ofertave është jo më pak se 10 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose ftesës për ofertë.

7. Procedurat e hollësishme të zhvillimit të kësaj procedure prokurimi parashikohen në rregullat e prokurimit publik.

III.1.8. Në nenin 46, pikat 2, të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është parashikuar se:

Llojet e procedurave që duhen përdorur në përzgjedhjen e kontratave të prokurimit publik, janë:

a) procedurë e hapur;

b) procedurë e kufizuar;

c) partneritet për inovacion;

ç) dialogu konkurrues;

d) shërbim konsulence;

dh) procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;

e) procedurë konkurruese me negociim, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave të sektorit klasik;

ë) procedurë me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave sektoriale;

f) procedurë e hapur e thjeshtuar;

g) prokurim me vlerë të vogël.

III.1.9. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është parashikuar se:

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*
3. *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

4. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
 - a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
 - b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
 - c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
 - ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
 - d) *Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*
5. *Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:*

- a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
 - b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.
 - c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.
 - ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.
7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur.

III.1.10. Në nenin 54, pikat 9 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është parashikuar se:

Përcaktimet e parashikuara në këtë nen janë njësoj të zbatueshme për konsulentin, si person fizik ose juridik, për stafin e konsulentit dhe nënkonsulentët, si dhe për bashkimet e konsulentëve.

Konsulentët mund të bashkohen me njëri-tjetrin, në formën e një bashkimi konsulentësh ose me një marrëveshje nënkonsulente, për plotësimin e fushave të tyre përkatëse të ekspertizës për fuqizimin e anës teknike të propozimeve të tyre dhe për vënien në dispozicion të një ekipi më të madh ekspertësh, për të ofruar propozime më të mira dhe, në disa raste, për të ofruar çmime më të ulëta. Një bashkim i tillë mund të krijohet për një afat të gjatë, pavarësisht nga detyra specifike ose mund të krijohet edhe për një detyrë të veçantë. Në çdo rast, ky bashkim duhet të dokumentohet me një kontratë të lidhur.

Në rastin e bashkimit të konsulentëve secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për kualifikim sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit në nenin 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.

III.1.11. Në nenin 76, “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:
- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;
- c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;
- ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

- a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;
- b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;
- c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

- c) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;
- d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të l egjislacionit në fuqi;
- dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;
- e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.
- ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratat të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;
- f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.
- g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepre penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.

Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.1.12. Në nenin 77, “Kërkesat për kualifikim” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të

njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.13. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave

apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.14. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH & “*Abkons*” SHPK, KPP konstaton se është paraqitur dokumenti Kontrata e bashkëpunimit të përkohshëm, ndërmjet shoqërisë “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH dhe shoqërisë “*Abkons*” SHPK, nga ku shoqëria “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH merr përsipër të ofrojë ekspertizën në - *Menaxhimin e Projektit*, - *Shërbim i Konsulencës për Shtrirjen Hekurudhore dhe Punët Civile*, - *Shërbimi i Konsulencës për Sistemet Hekurudhore*, - *Shërbimi i Konsulencës së Punimeve të Tunelit dhe Strukturës*, - *Shërbimet e identifikimit të itinerarit hekurudhor*, - *Shërbime konsulence në Telekomunikacion*, - *Shërbime konsulence hidraulike*, - *Shërbime konsulence të elektrifikimit*, - *Shërbime konsulence në inxhinieri strukturore (tunele)*, - *Shërbime konsulence në inxhinieri transporti*, - *Shërbime konsulence gjeoteknike*, - *Shërbime konsulence në Biologji*, - *Shërbime konsulence topografike*, - *Shërbime konsulence në shpronësimin dhe zhvendosjen e truallit*, - *Shërbime konsulence për Tokën*. Ndërsa shoqëria “*Abkons*” SHPK merr përsipër të ofrojë ekspertizën në – *Shërbime Mjedisore dhe Sociale*, - *Studime financiare dhe ekonomike*, - *Shërbimet e shëndetit dhe sigurisë në punë*, - *Studimet dhe investigimet e terrenit*, - *Shërbim konsulence në telekomunikacion*, - *Shërbime konsulence gjeoteknike*, - *Shërbime konsulence topografike*, - *Shërbime konsulence në inxhinieri transporti*, - *Shërbime konsulence në shpronësimin dhe zhvendosjen e truallit*.

III.1.15. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur nga BOE “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH & “*Abkons*” SHPK” sh.p.k., në përmbushje të kriterëve të kualifikimit, rezulton se pjesëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik “*Abkons*” sh.p.k ka paraqitur Certifikatat ISO 9001:2015 (Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë); ISO 14001:2015 (Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit), ndërsa pjesëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH ka paraqitur certifikatë Certifikatat ISO 9001:2015 (Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë). Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në rregullat e prokurimit publik, procedurave të shërbimit të konsulencës, i është dhënë një specifikë e vecantë lidhur me plotësimin e kriterëve të kualifikimit, ndryshe nga procedurat e tjera të prokurimit, duke përcaktuar se kriteret e vecanta të kualifikimit mund të plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi, kjo me qëllim fuqizimin e anës teknike të propozimeve të konsulentëve si staf teknik, kapacitetet ekonomike dhe financiare, si dhe për vënien në dispozicion të një ekipi më të madh ekspertësh, për të ofruar propozime më të mira dhe, në disa raste, për të ofruar çmime më të ulëta. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomik kryejnë aktivitetin objekt prokurimi sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes të certifikatave si ISO 9001:2015 (Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë); ISO 14001:2015 (Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit); Në këto kushte, përsa kohë që dhe ligjvënësi në nenin 54, pikat 9 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, ka parashikuar se: **Në rastin e bashkimit të konsulentëve secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për kualifikim**

sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit në nenin 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi, dhe vetë autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit kriterin e sipërcituar e ka përcaktuar në kriteret e vecanta të kualifikimit pjesë e nenit 77 të LPP-së. Gjithashtu referuar dhe proces-verbalit të argumentimit të kriterëve të vecanta të kualifikimit, publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton se autoriteti kontraktor për kriterin e mësipërm ka arsyetuar se: *“Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe neni 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”*. Referuar sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se autoriteti kontraktor kriterin kualifikues për të cilin është skualifikuar bashkimi i operatorëve ekonomik ankimes e ka kategorizuar dhe argumentuar bazuar mbi nenin 77 të LPP, ku sipas të cilit këto kriteret dhe rregulla të përcaktuara në nenin 77 të LPP **plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi**, ç’ka do të thotë se mjafton që njëri nga pjesëtarët e bashkimit ta plotësojë kriterin, kriteri do të konsiderohet i përmbushur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë në tërësi. Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik, në referim të dispozitës së sipërcituar gjykon se kapaciteti lidhur me plotësimin kërkesave të cilësisë është i bashkueshëm dhe nëse mungesa e këtij kapaciteti nga njëri prej pjesëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomik, mund të mbulohet nga plotësimi i këtij kapaciteti nga pjesëtari tjetër në bashkim. Komisioni gjykon se, certifikimi lidhur me plotësimin e standarteve nga një subjekt mund të garantojë se subjektet e tjera që bashkëpunojnë i plotësojnë këto standarte, nisur dhe nga tipologjia e objektit të veprimtarisë së subjektit. Sa më sipër, Komisioni gjykon se pavarësisht se pjesëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë *“ILF Consulting Engineers Austria”* GmbH me mosparaqitjen e vlefshme të certifikatave të kërkuara nga autoriteti kontraktor, sërisht garanton këtë të fundit autoritetin kontraktor se shërbimet tija do të kryhen sipas standarteve të cilësisë, për faktin se ky kriter plotësohet nga anëtari tjetër i bashkimit nga *“Abkons”* SHPK ndaj dhe ndodhemi në kushtet e përmbushjes të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3 të shtojcës 11/2, *“Për kapacitetin teknik”*, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi në përputhje me nenin 54, pikat 9 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*. Sa më sipër, arsyeja e skualifikimit për bashkimin e operatorëve ekonomik ankimesin nuk qëndron, pasi referuar dokumentacionit të dorëzuar në SPE, dispozitave ligjore të mësipërcituara përsa i përket përmbushjes së kriterëve nga bashkimi i operatorëve ekonomik në procedurat e shërbimit të konsulencës rezulton, se ky i fundit e plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit. Në rastin konkret, KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor, ashtu si edhe vetë autoriteti kontraktor ka parashikuar në procesverbalin e argumentimit të kriterëve duke e argumentuar këtë kriter mbi bazën e nenit 77 të LPP-së. Kështu, autoriteti kontraktor nuk mund të gjykojë a-priori dhe në mënyrë sipërfaqësore por duhej të analizonte në themel dokumentacionin e dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në përputhje me atë ç’ka parashikojnë dispozitat ligjore për procedurat e shërbimit të konsulencës. Kështu, rezulton e provuar se me anë të dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, bashkimi i operatorëve

ekonomikë ankimues e përmbushin kriterin për të cilin janë skualifikuar në tërësi si bashkim operatorësh në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues *“ILF Consulting Engineers Austria”* GmbH & *“Abkons”* SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues *“ILF Consulting Engineers Austria”* GmbH & *“Abkons”* SHPK, me argumentet se: *“Operatori Ekonomik ILF Consulting Engineers Austria GmbH ka paraqitur pasqyrat financiare të vitit 2019 dhe të vitit 2020 por nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të vitit 2021 sipas kërsave dokumentave standarteve të tenderit. Sa më sipër ky kriter konsiderohet i paplotësuar.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 11/2 *“Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”* pika 2.2/b *“Kapaciteti ekonomik dhe financiar”* autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

- a) Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë kopjet e pasqyrave financiare për vitet 2019, 2020, 2021, të paraqitura dhe të konfirmuara nga organet tatimore përkatëse, në zbatim të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë, ose legjislacionit në fuqi në vendin e origjinës. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorit ekonomik *“ILF Consulting Engineers Austria”* GmbH & *“Abkons”* SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Kontratë Bashkëpunimi për *“Studim i Fizibilitetit dhe Projekt Ide për Lidhjen Hekurudhore Durrës – Prishtinë”*, me Nr. 6998 Rep, Nr. 4216 Kol, datë 11.11.2022. Midis operatorit ekonomik *“ILF Consulting Engineers Austria”* GmbH dhe operatorit ekonomik *“Abkons”* SHPK

“Abkons” SHPK

- Shkresën nr. 692 prot, datë 25.08.2020 me objekt *“Kërkesë për konfirmim të Pasqyrave Financiare 2019 dhe raportit të Audituesit të Pavarur”*.
- Shkresën nr. 435 prot, datë 15.04.2021 me objekt *“Kërkesë për konfirmim të Pasqyrave Financiare 2020 dhe raportit të Audituesit të Pavarur”*.
- Shkresën nr. 905 prot, datë 12.11.2022 me objekt *“Kërkesë për konfirmim të Pasqyrave Financiare 2021 dhe raportit të Audituesit të Pavarur”*.

“ILF Consulting Engineers Austria” GmbH

- Pasqyrat Financiare për vitin 2019-2020.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.5. Në nenin 4 “Përkufizime” pika 17 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.6. Në nenin 41, pika 1, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor në përcaktimin e fituesve të kontratave publike zbaton procedurat e parashikuara në këtë ligj.

Llojet e procedurave të prokurimit publik janë:

- a) procedurë e hapur;
- b) procedurë e kufizuar;
- c) procedurë konkurruese me negociim, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave të sektorit klasik;
- ç) partneritet për inovacion;

- d) dialogu konkurrues;
- dh) procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave sektoriale;
- e) procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;
- ë) procedurë e hapur e thjeshtuar;
- f) **shërbim konsulence.**

III.2.7. Në nenin 50 “Shërbimi Konsulencës” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

1. Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me faza, e cila shërben për prokurimin e kontratave publike për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese.
2. Në procedurat mbi kufirin e lartë monetar, çdo operator ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të njoftimit që përmban informacionin e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik.
Afati kohor minimal për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje është jo më pak se 30 ditë nga data në të cilën është publikuar njoftimi i kontratës ose ftesa për shprehje interesi.
3. Në fazën e dytë, ofertë mund të paraqesin vetëm kandidatët e përzgjedhur nga autoriteti kontraktor.
Afati minimal për pranimin e ofertave është jo më pak se 30 ditë, nga data në të cilën është publikuar ftesa për ofertë.
4. Në procedurat mbi kufirin e lartë monetar, autoriteti kontraktor mund të shkurtojë me 5 ditë afatin kohor për marrjen e kërkesave ose ofertave, të përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, në rast se procedura e prokurimit zhvillohet me mjete elektronike.
5. Për procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, afati për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje ose ofertave është jo më pak se 20 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose ftesës për ofertë dhe në rast se procedura e prokurimit zhvillohet me mjete elektronike, ky afat mund të shkurtohet me 5 ditë.
6. Për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, afati për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje ose ofertave është jo më pak se 10 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose ftesës për ofertë.
7. Procedurat e hollësishme të zhvillimit të kësaj procedure prokurimi parashikohen në rregullat e prokurimit publik.

III.2.8. Në nenin 46, pikat 2, të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është parashikuar se:

- Llojet e procedurave që duhen përdorur në përzgjedhjen e kontratave të prokurimit publik, janë:
- a) procedurë e hapur;
 - b) procedurë e kufizuar;
 - c) partneritet për inovacion;
 - ç) dialogu konkurrues;
 - d) shërbim konsulence;**
 - dh) procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;

- e) procedurë konkurruese me negocim, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave të sektorit klasik;
- ë) procedurë me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave sektoriale;
- f) procedurë e hapur e thjeshtuar;
- g) prokurim me vlerë të vogël.

III.2.9. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është parashikuar se:

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.
2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.
3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- e) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
 - f) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
 - g) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
 - ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
 - h) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.
5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:
- a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
 - b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.
 - c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.
 - ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.
7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur.

III.2.10. Në nenin 54, pikat 9 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është parashikuar se:

Përcaktimet e parashikuara në këtë nen janë njësoj të zbatueshme për konsulentin, si person fizik ose juridik, për stafin e konsulentit dhe nënkonsulentët, si dhe për bashkimet e konsulentëve.

Konsulentët mund të bashkohen me njëri-tjetrin, në formën e një bashkimi konsulentësh ose me një marrëveshje nënkonsulente, për plotësimin e fushave të tyre përkatëse të ekspertizës për fuqizimin e anës teknike të propozimeve të tyre dhe për vënien në dispozicion të një ekipi më të madh ekspertësh, për të ofruar propozime më të mira dhe, në disa raste, për të ofruar çmime më të ulëta. Një bashkim i tillë mund të krijohet për një afat të gjatë, pavarësisht nga detyra

specifike ose mund të krijohet edhe për një detyrë të veçantë. Në çdo rast, ky bashkim duhet të dokumentohet me një kontratë të lidhur.

Në rastin e bashkimit të konsulentëve secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për kualifikim sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit në nenin 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.

III.2.11. Në nenin 76, “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;
- c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;
- ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të

tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepre penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.

Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.2.12. Në nenin 77, “Kërkesat për kualifikim” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në

fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.13. Në nenin 25 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t'u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Këto kritere synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.”

Në nenin 89, pika 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se a) ofertat dorëzohen në rrugë elektronike, sipas përcaktimit në aktet nënligjore; ose b) ofertat dorëzohen me shkrim, nëse një gjë e tillë është parashikuar në aktet nënligjore, dorazi ose përmes postës, të nënshkruara dhe të mbyllura në zarf.

III.2.14. Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 thuhet se:

“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji...”

III.2.15. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.16. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues thema decidendum, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH është një subjekt juridik i regjistruar dhe themeluar në Republikën Federale të Austrisë dhe domosdoshmërisht i nënshtrohet ligjeve të shtetit të origjinës. Në nenin 4, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se “*E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit*”, Komisioni i Prokurimit Publik nënvizon faktin se nuk është në kompetencën dhe juridiksionin e tij interpretimi i një norme juridike të një shteti të huaj, por nënvizon faktin se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik organizuar konform ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, në Republikën e Shqipërisë janë të detyruar të pëgratisin ofertat e tyre në përputhje me LPP, aktet normative në zbatim të tij dhe dokumenteve të procedurës së prokurimit publikuar nga autoriteti kontraktor. Në plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit/pranimit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentin me emërtim “*ILF Balance Sheets*” lëshuar më datë 25.11.2022 nga Moore SSK. Referuar arsyes se skualifikimit Komisioni Prokurimit Publik duke qënë se ndodhet përpara faktit ku njëri nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomik është operatorë ekonomik i huajkonkretisht i regjistruar në Republikën Federale Austriake i cili domosdoshmërit i nënshtrohet legjislacionit të vëndit të origjinës për një gjykim të drejtë dhe transparent ju drejtua zyrtarisht fillimisht Ambasadës së Republikës Federale të Austrisë në Shqipëri me shkresën nr. 2817/5 prot, datë 12.01.2023 dhe më pas nëpërmjetë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë me shkresën nr. 2817/6 prot., datë 12.01.2023, ju drejtua Ministrisë së Financave të Republikës Federale të Austrisë, nga të cilat ka kërkuar informacion si vijon: “*Sipas legjislacionit të Republikës Federale të Austrisë, cili është afati përfundimtar (datë/muaj/vit) që një subjekt i regjistruar në regjistrat tregtarë Austriak ka detyrim ligjor të deklarojë/auditohet/certifikohet pasqyrat e tij financiare pranë organeve shtetërore ose subjekteve të tjera për vitin ushtrimor 2021*”. Në datë 06.04.2023 nëpërmjetë postës elektronikë Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë ka dërguar informacion i cili është protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me shkresën nr. 2817/11 prot, datë 06.04.2023 me përmbajtje si më poshtë vijon: “*Referuar rregullores së përgjithshme standarde për raportimin ligjor financiar në Austri: kompanitë që operojnë në tregun austriak, e kanë detyrim ligjor të kryejnë raportimin vjetor financiar jo më vonë se 5 muaj nga data e dorëzimit të pasqyrës së bilancit financiar. Data e dorëzimit të bilancit financiar varion nga madhësia e kompanisë dhe statusi juridik. Në rastin konkret, për “sh.p.k”(GmbH – ekuivalent i LLC në vendet anglo – saksone), deklarata për tatim mbi fitimin në Austri (UVA-TVSH-VAT) bëhet 4 herë në vit për ndërmarrjet, të cilat kanë deklaruar fitim më pak se €100K për vitin e mëparshëm. Në rastet kur fitimet e deklaruara janë në €35K, nuk ka nevojë për deklarim të mëvonshëm, në rast se pagesat përkatëse janë kryer në datat specifike, përkatësisht: 15 shkurt, 15 maj, 15 gusht, 15 nëntor. Si rregull, për kompanitë që dorëzojnë bilancin financiar në 31 dhjetor, kanë kohë të dorëzojnë raportimin vjetor financiar deri në 30 mars. Ato që bëjnë deklarimin në 30 qershor, duhet të dorëzojnë raportin vjetor financiar deri në fund të shtatorit. 9 muaj pas dorëzimit të bilancit financiar, zyra e operatorit të firmës është e detyruar në bëj publikimin e hapur në regjistrin publik të auditit (në rastin e firmave të mëdha si Kleopatra, raporti përfshihet në publikimin zyrtar të gazetës “*Öiener Zeitung*”).*

Referuar përjashtimit si pasojë e pandemisë dhe lehtësimet e marra nga qeveria austriake: për shkak të vështirësive të krijuara nga pandemia COVID-19, afati përfundimtar për dorëzimin e raportit vjetor financiar u vendos të shtyhej nga 5 deri në 9 muaj. Ndërsa afati për hedhjen në regjistrin publik, u shty nga 9 deri në 12 muaj (Vendim i marrë nga Këshilli Kombëtar – Parlamenti- i Austrisë në datën 19 maj 2022 dhe hyrë në fuqi në datën 11 qershor 2022). Ky vendim vlente për dorëzimin e raportit vjetor financiar për firmat me afat bilanci financiar deri më 31 dhjetor 2021, për të cilat afati i përgatitjes nuk skadonte më në 16 mars 2020. Në këtë kuadër, për firmat që kishin bilanc financiar të dorëzuar deri në 31 dhjetor 2021, raportimi vjetor financiar duhej të kryhej deri në 30 shtator 2022, ndërsa hedhja në regjistrin publik deri në 31 dhjetor 2022. Për bilancet financiar pas 31 dhjetorit 2021 dhe deri në 29 prill 2022, rregulli ndryshon përkatësisht për raportin vjetor financiar ishte 30 shtatori 2022, ndërsa për regjistrin publik afati ishte 31 dhjetori 2022. Dhe për bilancet financiare me afat nga 30 prilli 2022 e pas, ri hynte në fuqi rregullorja standarde me afatet përkatësisht 5 muaj për raportimin vjetor financiar pas dorëzimit të bilancit financiar, dhe 9 muaj (nga dorëzimi i bilancit financiar) për hedhjen në regjistrin publik.

Për periudhën 2019 – 2021, qeveria austriake ndoqi një politikë të ngjashme. Vendimi i qeverisë austriake për hedhjen e të dhënave në regjistrin publik u shty me 12 maj, por u aplikua në ato raste kur bilancet financiare nuk kishin afat dorëzimi datën 16 mars brenda periudhës 6 mujore, dhe për të cilat afati përfundimtar ishte përpara datës 1 gusht 2020. Kjo përkthehet për operatorët që, detyrimi i dorëzimit të raporti financiar vjetor vlen në ato raste afati i dorëzimit të bilancit financiar binte në periudhën midis datës 16 tetor 2019 dhe 31 korrik 2020. Për të gjitha raportimet vjetore financiare me një bilanc financiar pas 31 korrikut 2020, aplikohet sërish detyrimi i mëparshëm 9-mujor. Kështu, për bilancin financiar nga 31 gushti 2020, detyrimi ligjor për hedhjen e të dhënave në regjistrin publik ishte 9 muaj pas, pra maksimumi 31 maj 2021”. Duke marrë shkas nga kthim përgjigjia e sipërcituar administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues në ankesë i cili pohon se në legjislacionin austriak është e përcaktuar se operatorët ekonomik për pasqyrat financiare të vitit 2021 kanë afatë për dorëzimin e tyre në regjistrat publik deri në 31 dhjetorë 2022, autoriteti kontraktor përpara vlerësimit të procedurës së prokurimit duhej të zbatonte momentin procedural të parashikuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, pra të kërkontë sqarime nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues ose të kryente hetim të thelluar në lidhje me konstatimin pranë organeve kompetente të vëndit të origjinës së anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomik të skualifikuar. Kjo pasi procedura prokurimit objekt shqyrtimi është publikuar në sistemin e prokurimeve më datë 14.10.2022, dhe shprehja interesit për këtë procedurë për operatorët ekonomik të interesuar ka qënë data 07.12.2022, ndërkohë referuar sqarimit të sipërcituar rezultojnë afate të ndryshme për dorëzimin e pasqyrave financiare nga operatorët ekonomik në regjistrin publikë, pra e thënë ndryshe sipas informacionit të sipërcituar operatorët ekonomik në Republikën Federale të Austrisë kanë patur afat për dorëzimin e pasqyrave financiare ndryshe nga legjislacioni shqipëtar i cili parashikon se “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në

organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji”. Në lidhje me faktin se operatori ekonomik *ILF Consulting Engineers Austria* GmbH nuk ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike pasqyrat financiare të vitit 2021 në përmbushje të kriterit të vecantë të kualifikimit/pranimit të parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi, K.P.P. gjykon të ndalet në dy momente juridike të vlefshmërisë së dokumentacionit të dorëzuar dhe të mundësisë së marrjes së një dokumentacioni zyrtar për të cilin operatori ekonomik ofertues ka patur ende afat ligjorë për të dorëzuar ato pranë organeve kompetente. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të drejtohet për interpretim kuadrin ligjor në shtetin e origjinës në zbatim të parimit juridik se *lexi loci actus* (zgjidhja e çështjes jepet në bazë të ligjit të origjinës të aktit). Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike Dokumentin me emërtim *“ILF Balance Sheets”* lëshuar më datë 25.11.2022 nga Moore SSK, me anë të të cilit operatori ekonomik ankimues provon certifikimin e pasqyrave financiare për vitet 2019-2020, ndërkohë për pasqyrat financiare të vitit 2021 parashikohen afate të ndryshme kjo në varësi të statusit juridik të operatorit ekonomik. Në lidhje me pretendimin e autoritetit kontraktor se ky operator ekonomik nuk ka dorëzuar pasqyrat financiare për vitin 2021 ashtu sikurse është kërkuar dhe në dokumentat standarte të tenderit nëse i lind e drejta (*oritur jus*) të kërkojë marrjen e një dokumentacioni konkretisht pasqyrave financiare të vitit 2021 për të cilin ligji i vëndit të origjinës ka të përcaktuar rregulla të ndryshme për dorëzimin e pasqyrave financiare të vitit 2021 pranë organeve kompetente. K.P.P. gjykon se në cilësinë e një organi juridik publik quasi gjyqësor të krijuar me ligj në Republikën e Shqipërisë, ky i fundit nuk mund të interpretojë kuadrin ligjor të një shteti të huaj. Referuar dhe sqarimit të sipërcituar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për sa kohë që për dorëzimin e pasqyrave financiare ka të parashikuara rregulla të ndryshme në varsi të statusit juridik të operatorit ekonomik atëherë autoriteti kontraktor kishte detyrimin ligjorë të hetonte në vëndin e origjinës ose të kërkonte sqarim nga operatori ekonomik nëse ky i fundit ndodhej në kushtet e pamundësisë për paraqitjen e pasqyrave financiare për vitin 2021 për shkak të rregullave që përcakton ligji në vëndin e tij të origjinës. Të ndodhur në këto kushte, duke marrë në konsideratë natyrën e vendimeve të dhëna nga Komisioni i Prokurimit Publik, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, në frymën e të cilave, vendimet e dhëna nga Komisioni i Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohen akte administrative, në kuptimin normal juridik të termit (*strictu sensu*), por akte *“sui generis”* të nxjerra nga një organ *“sui generis”*, për të cilin Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përdorur termin e ri leksikor, quasi gjykatë, e pranuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, K.P.P. gjykon se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga lex specialis ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ndaj K.P.P. gjykon t’i referohet situatave analoge me çështjet gjyqësore për të cilat parashikohen në nenin 37 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 *“Kodi i procedurës civile”* i ndryshuar, ku përcaktohet se *“Juridiksioni i gjykatave shqiptare për personat fizikë dhe juridikë të huaj rregullohet me ligj”*. Në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se *“Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: a) Kushtetuta; b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c) ligjet; ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave. 2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe. 3. Aktet*

normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre” Në interpretim të dispozitës së sipërcituar, K.P.P. gjykon se miratimi i dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit është një akt nominal i miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik në zbatim të nenit 23 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe si tillë, interpretimi i dokumentacionit të mësipërm do të referohemi për interpretim dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit. Në shtojcën 11/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.2/b “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” autoriteti kontraktor ka përcaktuar se Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë kopjet e pasqyrave financiare për vitet 2019, 2020, 2021, të paraqitura dhe të konfirmuara nga organet tatimore përkatëse, në zbatim të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë, ose legjislacionit në fuqi në vendin e origjinës. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, K.P.P. konstaton se operatori ekonomik inter allia ka dorëzuar Pasqyrat Financiare për vitin 2019-2020 të lëshuara nga Moore SSK, referuar kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarde të tenderit ku thuhet të paraqiten pasqyrat financiare për vitet 2019, 2020, 2021, të të konfirmuara nga organet tatimore përkatëse, në zbatim të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë, ose legjislacionit në fuqi në vendin e origjinës, duke marrë shkas nga arsyeja e skualifikimit të anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues si dhe referuar sqarimit të përcjellë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në të cilën sqarohet se legjislacioni i vëndit të origjinës së anëtarit të bashkimit të operatorit ekonomik ankimues parashikon rregulla dhe afate të ndryshme për paraqitjen e pasqyrave financiare, ndryshe nga ç’ka parashikon legjislacion në Republikën e Shqipërisë i cili ka përcaktuar si afat përfundimtar për dorëzimin e pasqyrave financiare të vitit 2021 datën 31 Mars 2022, gjykon se autoriteti kontraktor nëse do të kishte dyshime/pretendime apo shfaqte kërkesën për sqarime për dokumentacionin e dorëzuar ka patur në dispozicion momentin procedural të parshaikuar nga neni 92 i ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, për kryerjen e verifikimeve përkatëse apo marrjen e sqarimeve, apo kryerjen dhe të hetimeve të thelluara në shtetin e origjinës të anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues. Në rastin konkret K.P.P, gjykon se nuk mund të marrë tagrin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, por në dritën e përgjigjes së dhënë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, është detyrë e autoritetit kontraktor për një vlerësim sa më të drejtë dhe transparent të rivlersojë procedurën e prokurimit në përputhje me parashikimet e nenit 92 i ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomik ankimuese qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin

e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH & “*Abkons*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr. REF- 45735-10-13-2022, me objekt: “*Studim i Fizibilitetit dhe Projekt - Ide për Lidhjen Hekurudhore Durrës -Prishtinë*”, me fond limit 200,224,996 (dyqind milionë e dyqind e njezetë e katër mijë e nëntë qind e nëntë dhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH ose 1.708.696 Euro (një milion e shtatëqind e tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) Euro kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 07.10.2022, 1 euro = 117.18 lekë, zhvilluar me datë 07.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Hekurudha Shqiptare.
 2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi duke respektuar parashikimet e nenit 92 i ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” dhe nenin 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” të ndryshuar.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH & “*Abkons*” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri